

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A duhej pritur Apeli? Haga nis procedurën për kompensimin e viktimave - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/a-duhej-pritur-apeli-haga-nis-proceduren-per-kompensimin-e-viktimave/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 12:53:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 12:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f7b973ce66151014fd07a01ae77697d5cef260fd4d795100bbb05b29e2701515
TEKSTI	a3ae0475d1af905ceec6896925664ef3f50acedc19b408b877866cd991e62c22
PAMJA	9b3a4c654de3010425c060d406d875e8e6373d3668d4556f18adc2452561faa7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5f100a8434632b9f34cb38c6089cddaedece413721cb814ea57172f84b2fc367
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	eb349e27d97627815188dff3df4e0bc201b670467eee4614341dacf1fe64501a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5f100a8434632b9f34cb38c6089cddaedece413721cb814ea57172f84b2fc367>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » A duhej pritur Apeli? Haga nis procedurën për kompensimin e viktimave

KOSOVË

Demo

A duhej pritur Apeli? Haga nis procedurën për kompensimin e viktimave

SEPTEMBER 20, 2026



Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë nisur procedurën për përcaktimin e reparacioneve për viktimat në çështjen gjyqësore ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Vendimi është marrë më 16 shtator nga kryetari i Trupit Gjyqësor, Charles L. Smith, në të njëjtën ditë kur u shpall aktgjykimi i shkallës së parë ndaj katër ish-kryerëve të UÇK-së. Gjykata i gjeti ata penalisht përgjegjës për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes, ndërsa shqiptoi dënime prej 25 vitesh burgim për Thaçin dhe Krasniqin, 18 vitesh për Veselin dhe 13 vitesh për Selimin.

Sipas vendimit të Trupit Gjyqësor, procedura për reparacionet do të zhvillohet në bazë të nenit 22(8) të Ligjit dhe rregullës 168 të Rregullores, nëse Mbrojtja nuk paraqet kundërshtim. Afati për kundërshtimin e nisjes së procedurës është 22 shtatori. Nëse nuk ka kundërshtim, Përfaqësuesi i Viktimave duhet të paraqesë kërkesën konkrete për reparacione deri më 14 tetor, ndërsa Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtja kanë afat deri më 4 nëntor për t'iu përgjigjur.

Nisja e kësaj procedure vetëm një ditë pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë ka hapur diskutimin nëse duhej pritur përfundimi i procesit gjyqësor në shkallën e dytë, përpara se të përcaktoheshin reparacionet për viktimat.

Avokati Ardian Bajraktari argumenton se, si rregull, procedura për kompensimin e viktimave duhet të nisë pasi vendimi penal të bëhet i formës së prerë. Sipas tij, për sa kohë aktgjykimi mund të ndryshojë në Gjykatën e Apelit, nisja e procedurës në këtë fazë është e parakohshme.

"Si rregull, procesi i kompensimit të viktimave fillon pas plotfuqishmërisë së vendimit. Mirëpo, kur jemi te Gjykata Speciale, anomali, veprimet në kundërshtim me ligjin kanë qenë ato që e kanë karakterizuar në vazhdimësi procesin, prandaj një gjë e tillë ka qenë në vazhdimësi diçka e rëndomtë për këtë gjykatë. Vlerësoj që, mbi të gjitha, një veprim, një vendim i tillë është i parakohshëm për aq kohë sa nuk kemi akoma vendim të plotfuqishëm", ka thënë Bajraktari.

Sipas tij, vendimi që mund të marrë Gjykata e Apelit mund të ndryshojë edhe bazën mbi të cilën po zhvillohet procedura e reparacioneve, çka, sipas këtij interpretimi, e bën të diskutueshme nisjen e saj përpara përfundimit të procesit penal.

Një tjetër interpretim vjen nga ish-kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Hasani. Ai vlerëson se procedura për kërkesën pasurore-juridike mund të zhvillohet paralelisht me çështjen penale dhe se nuk është domosdoshmërisht e nevojshme të pritët vendimi i Gjykatës së Apelit.

Ndërkohë, vetë Dhomat e Specializuara kanë bërë të ditur se Trupi Gjyqësor ka zgjedhur të zhvillojë procedurën e reparacioneve dhe të nxjerrë një urdhër për kompensimin e viktimave, në vend që t'i drejtojë ato drejt një procesi civil në Kosovë, me kusht që Mbrojtja të mos paraqesë kundërshtim. Në

Postimet e reja

A duhej pritur Apeli? Haga nis procedurën për...

SEPTEMBER 20, 2026

OKB në një moment kritik/ Liderët botërorë...

SEPTEMBER 20, 2026

Meloni paralajmëron kufizime në shkolla: Tava...

SEPTEMBER 20, 2026

Marrëveshja për Groenlandën/ Trump:...

SEPTEMBER 20, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematicët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

këtë çështje janë 156 viktime pjesëmarrëse.

YouTube

TikTok

Aktgjykimi i 16 shtatorit është i shkallës së parë dhe ekipet mbrojtëse kanë paralajmëruar apelimin e tij. Sipas procedurës, edhe Mbrojtja, edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund ta apelojnë vendimin e shkallës së parë.

Haga

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët,
mundësi fitimi dhe sfida në punë,
çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3
shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.